

Vendim nr. 237, datë 13.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Asim Vokshi,	Anëtar

në datën 13.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (L) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **LAVDOSH SHEHU**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 46, datë 27.07.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 58, datë 14.12.2022 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1401, datë 23.09.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 30, 32, 36, 42, 49, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 71/a i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës**

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është proceduar penalisht nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 245/1, paragrafi 2, dhe 25 të Kodit Penal (KP).

2. Sipas Prokurorisë së Posaçme, gjatë hetimeve paraprake janë ngritur dyshime se kërkuesi dhe shtetasi H.T., që ka punuar si shofer në Ministrinë e Drejtësisë, kanë marrëdhënie shoqërore me njëri-tjetrin dhe se së bashku kanë konsumuar elementet e veprës penale, për të cilën janë akuzuar, duke premtuar se do të ndikonin te një funksionar i lartë i Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim për të transferuar në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në Shqipëri shtetasin shqiptar F.H., i dënuar me burgim nga gjykatat italiane. Pasi ky i fundit ka kontaktuar kërkuesin si avokat për të marrë përsipër çështjen e tij, kërkuesi ka rënë dakord me të pandehurin H.T., që ka konfirmuar se do të merrte përsipër transferimin në Shqipëri, për të cilin F.H. duhet të paguante 12.000 euro dhe për këtë duhej të pajisej me prokurë. Pas këtij takimi, shtetasja Sh.H., e ëma e F.H., ka lëshuar një prokurë të posaçme, duke emëruar kërkuesin si përfaqësues të djalit të saj. Rreth muajve korrik-shtator 2020, pasi ajo është takuar me kërkuesin, kanë rënë dakord se shuma totale e pagesës ishte 12.000 euro, nga të cilat ajo do të paguante paraprakisht shumën prej 5.000 eurosh dhe pjesën tjetër me transferimin e F.H. Në të njëjtën periudhë Sh.H. i ka dorëzuar personalisht shumën prej 5.000 eurosh kërkuesit, i cili i kishte premtuar që në datën 10.10.2020 F.H. do transferohej në Shqipëri. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është pranuar kërkesa e të dënuarit F.H., përfaqësuar në atë gjykim nga kërkuesi, për të njohur vendimin penal të autoriteteve gjyqësore italiane, duke konvertuar edhe dënimin. Ky vendim njohjeje i është përcjellë Ministrisë së Drejtësisë. Shtetasja M.B., motra e të dënuarit F.H., në muajin mars të vitit 2021 i ka kërkuar kërkuesit garantimin e transferimit të të vëllait, ose kthimin mbrapsht të vlerave monetare të paguara. Këtë kërkesë kërkuesi ia ka përcjellë të pandehurit H.T. E ëma e të dënuarit F.H. në muajin maj 2021 ka komunikuar në telefon me gazetarët e një emisioni televiziv investigimi për këtë çështje dhe së bashku me një gazetarë ka takuar kërkuesin në zyrën e tij, duke regjistruar bisedën, ndërsa në datën 08.06.2021 ajo ka paraqitur kallëzim në Prokurorinë e Posaçme ndaj kërkuesit. Më 06.07.2021 është kryer transferimi nga Roma (Itali) drejt Shqipërisë i të dënuarit F.H.

3. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr.46, datë 27.07.2022, ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 245 dhe 25 të KP-së dhe dënimin e tij me 1 vit e 9 muaj burgim dhe, në bazë të nenit 406, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), e ka dënuar atë përfundimisht me 1 vit e 2 muaj burgim. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur apel kërkuesi dhe i pandehuri H.T.

4. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 58, datë 14.12.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 46, datë 27.07.2022 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkuesi dhe H.T.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025- 1401, datë 23.09.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, pasi ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në të nuk janë nga ato që përcaktohen në nenin 432 të KPP-së.

6. Në datën 07.04.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave ligjore, është regjistruar më 20.04.2026.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë* të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet gjyqësore nuk japin një përgjigje reale dhe efektive ndaj pretendimeve të ngritura nga kërkuesi për natyrën e marrëdhënies juridike me shtetasen Sh.H., e cila ka qenë një marrëdhënie profesionale, e dokumentuar me faturë tatimore dhe veprime konkrete ligjore. Vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural dhe miratimi i tij nga GJKKO-ja e Apelit është i gabuar. Ato gjykata kanë arsyetuar rreth një zinxhiri veprimesh të palidhura me njëra-tjetrën midis kallëzueses dhe kërkuesit dhe nuk kanë marrë parasysh argumentin se midis fillimit të përfaqësimit të çështjes nga ai dhe kohës së njohjes me të bashkëpandehurin ka një shkelje kohore. Ky element i fundit e bën alogjik arsyetimin e gjykatave mbi kohën e premtimit. Gjykata e Lartë nuk ka ushtruar asnjë kontroll mbi shkeljet e

realizuara nga gjykatat e faktit, por është mjaftuar me një arsyetim formal se pretendimet në rekurs marrin përgjigje nga gjykata e apelit dhe se shkaqet e paraqitura lidhen me vlerësimin e provave, ndonëse pretendimet lidheshin me përdorimin e provave të paligjshme dhe mungesën e arsytimit të mjaftueshëm. Ndonëse pranon se nuk shqyrton prova, pasi nuk është gjykatë fakti, në të njëjtën kohë ajo gjykatë mbështet plotësisht konkluzionet e gjykatave më të ulëta, pa i verifikuar më parë ato.

7.2. *Parimit të prezumimit të pafajësisë dhe së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, të garantuara respektivisht nga nenet 30 dhe 32, pika 2, të Kushtetutës, pasi:

7.2.1. Përfundimi për fajësinë e kërkuesit nuk është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe nuk është mbështetur në prova të drejtpërdrejta, por në interpretime dhe në deklaramet e njëanshme të kallëzueses, në fragmente komunikimesh dhe në një regjistrim të fshehtë, i cili, sipas gjykatës së apelit, përbën provë atipike, edhe pse është marrë në mënyrë të paligjshme.

7.2.2. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh faktin se regjistrimi i emisionit televiziv është marrë në mënyrë të paligjshme, pasi është marrë jashtë dhe përpara procedimit penal, nga persona anonimë, pa asnjë garanci për vërtetësinë dhe integritetin e tij dhe pa u nënshtruar kontrolli i duhur gjyqësor, ndërkohë që është përdorur si provë thelbësore për të ndërtuar përgjegjësinë penale. Përgjimi në fjalë nuk është autorizuar nga gjykata ose prokuroria dhe, në këtë kuptim, përbën kundërvajtje penale në bazë të nenit 121 të KP-së “Ndërhyrje të padrejta në jetën private” dhe bie ndesh edhe me *nenin 36 të Kushtetutës* që garanton fshehtësinë e komunikimeve.

7.2.3. Gjykatat kanë bërë një interpretim të zgjeruar të figurës së veprës penale, duke arsyetuar se mjafton vetëm kërkimi ose marrja e përfitimit të parregullt, pa qenë nevoja që ndikimi të realizohet. Kërkuesi nuk provohet që ta ketë konsumuar nga ana objektive këtë vepër penale, pasi ai nuk ka premtuar të ushtrojë ndikim paligjshëm në format që parashikon neni 245/1 i KP-së. Pagesa është kryer për shërbimin ligjor të ofruar nga kërkuesi dhe është shoqëruar nga fatura tatimore përkatëse dhe për të është paguar edhe tatimi në burim, ndërsa gjykatat nuk kanë arritur të provojnë qartësisht të kundërtën, duke barazuar kështu ushtrimin e profesionit të avokatit me një veprimtari kriminale, në cenim të drejtpërdrejtë të *lirisë në ushtrimin e profesionit*. Vetë familjarët e kallëzueses e kanë bërë një deklaramet të tillë, në kundërshtim me sa është kallëzuar nga ajo. Edhe fakti se i dënuari F.H. dhe nëna e tij nuk janë marrë të pandehur, shkon në

favor të këtij argumenti. Sipas gjykatës së apelit, provohet implikimi i të pandehurve duke premtuar se zotërojnë aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm, por ky konkluzion nuk mbështetet në asnjë provë konkrete që të tregojë ekzistencën e një ndikimi real, të një vendimmarrjeje të ndikuar ose të një lidhjeje efektive me funksionarë publikë. Ministria e Drejtësisë është thjesht një urë komunikimi ndërmjet institucioneve gjyqësore të të dyja shteteve, ajo nuk ka asnjë rol vendimmarrës. Përveç kësaj, procedura e transferimit ka ndjekur rrugën ligjore dhe institucionale, çka bie në kundërshtim me tezën e ndikimit të paligjshëm.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ai plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i

fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 23.09.2025, dhe u është njoftuar avokatëve të kërkuarit nëpërmjet postës elektronike në datën 05.12.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 07.04.2026, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

10. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës proces te rregullt ligjor në drejtim të së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të prezumimit të pafajësisë, si dhe së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Për sa u takon këtyre pretendimeve, bazuar në natyrën dhe në thelbin e këtyre pretendimeve, Kolegji vëren se ato kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të standardit kushtetues të të provuarit të fajësisë tej çdo dyshimi të arsyeshëm, sipas nenit 30 të Kushtetutës, si dhe me mënyrën e arsytimit të gjykatave të zakonshme për përcaktimin e fajësisë së kërkuarit për veprën penale për të cilën është dënuar, sipas nenit 42 të Kushtetutës, për rrjedhojë do të analizohen në këtë drejtim.

11. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit. Çështjet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrë e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimin të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të

rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur, dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Kurse për sa i përket standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, në kuptim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se ai është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Bazuar në vendimet gjyqësore që kanë shqyrtuar çështjen e kërkuarit, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë e ka deklaruar fajtor atë, pasi ka çmuar se rezulton i provuar konsumimi i veprës penale, për shkak se ai ka kërkuar, ka marrë dhe ka pranuar para, duke premtuar dhe siguruar se ka aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës të zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim kryerjen e transferimit të të dënuarit F.H. dhe këtë ndërhyrje do ta realizonte nëpërmjet bashkëpunimit me të bashkëpandehurin. Në këtë konkluzion ajo gjykatë ka arritur pasi ka çmuar se kërkuari i ka premtuar kallëzueses se mund të merrte përsipër çështjen e djalit të saj, me qëllim transferimin në Shqipëri; se kjo punë do t'i kushtetonte 12.500 euro, duke i thënë asaj “dihet sesi janë këto punë” dhe përfundimisht kanë rënë dakord për një shumë prej 12.000 eurosh; se kërkuari i ka premtuar se është në gjendje të arrijë rezultatin e kërkuar, duke kërkuar dhe marrë një pjesë të parave të kërkuara. Gjatë bisedës së regjistruar nga kallëzuesja dhe personi që e ka shoqëruar, kërkuari shprehimisht i ka thënë se punën e tij e kishte mbaruar, por F.H. nuk po transferohej për faj të të tjerëve, të cilët kishin marrë paratë. Në atë bisedë ai pretendon se i ka thënë dhëndrit të kallëzueses se është i gatshëm ta çojë te njeri që ka marrë “porosinë” e tyre; pranon se për transferimin i është kërkuar një shifër e çmëndur dhe këtë e pohon kur kallëzuesja shprehet se 5.000 euro i janë dhënë ndërkohë avokatit dhe se nuk kundërshton shifrën prej 12.000 eurosh. Të dhënat e mësipërme, sipas asaj gjykate, vijnë në harmoni edhe me faktet vijuese: i) kërkuari i ka kthyer kallëzueses një shumë prej 900 eurosh për shkak të vështirësive që kjo ka pasur; ii) kërkuari pranon se i kanë thënë se çështja ishte mbyllur, ndërkohë që doli se nuk ishte mbyllur; iii) kërkuari pranon se shuma prej 5.000 eurosh ka shkuar diku dhe përmend emra funksionarësh publikë me bindje; iv) nga biseda e bërë me të bashkëpandehurin H.T. kërkuari shprehet se për të qenë në rregull paratë i ka deklaruar si të ardhura, duke paguar edhe tatim në burim; v) kur kërkuarit i kërkohet me insistim nga familjarët e të dënuarit F.H. përfundimi i procedurës, ai i drejtohet me fjalë të ashpra të bashkëpandehurit, që është i vetmi person të cilit i kërkon llogari për transferimin. Deklarimet e të pandehurve se ata nuk kanë komunikuar dhe

bashkëpunuar në ushtrimin e ndikimit të paligjshëm, janë vlerësuar me rezervë nga gjykata për sa kohë nuk kanë gjetur mbështetje në provat e tjera të administruara. Pretendimi se kërkuesi, përveç se shërbimit të mbrojtjes ligjore, të shoqëruar edhe me faturë tatimore përkatëse, nuk ka shkelur asnjë normë ligjore, është konsideruar nga gjykata si alibi për t'iu shmangur përgjegjësisë ligjore dhe dënimit penal.

14. Vendimi i mësipërm është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit, e cila ka vlerësuar se në gjykimin objekt ankimi janë zbatuar në mënyrë korrekte rregullat e procedurës penale në një gjykim të posaçëm (rit i shkurtuar gjykimi) sipas nenit 405 të KPP-së, për kërkesën e dy të pandehurve, të cilët, pasi janë njohur me aktet dhe provat, nuk kanë ngritur kontestime mbi vlerën dhe përdorshmërinë e tyre dhe, po ashtu, gjykata e seancës paraprake, sikundër edhe ajo e gjykitimit në themel, nuk kanë konstatuar pavlefshmëri absolute apo papërdorshmëri të provave. Ajo gjykatë e ka gjetur të pabazuar pretendimin për qëndrimin paragjykses gjykatës së shkallës së parë, pasi ka vlerësuar se ajo gjykatë ka vlerësuar në mënyrë të saktë të dhënat e provave dëshmi, konkretisht ato të deklaruesve F.H., Sh.H., M.E.B. (i dënuari i interesuar për t'u transferuar në Shqipëri dhe familjarët e tij), të deklaruesve O.F., L.K., D.S., B.K., A.M. (zyrtarë publikë në Ministrinë e Drejtësisë), duke i analizuar në raport me provat e tjera të përfutuara nga ekspertimet kompjuterike, transkriptimet e përgjimeve, të dhënat e kompanive telefonike dhe ato të përfutuara nga regjistrimi i komunikimeve me pajisjet regjistruese të emisionit televiziv, vlerësim, që, për rrjedhojë të respektimit të dispozitave të nenit 152 të KPP-së dhe të logjikës, është çmuar i drejtë sipas asaj gjykate. Për pretendimin se gjykata e shkallës së parë nuk ka respektuar *parimin e prezumimit të pafajësisë* dhe ka cenuar rëndë parimin e provueshmërisë, gjykata e apelit ka arsyetuar se procesi gjyqësor i zhvilluar mbi ritin e shkurtuar të tij, dhe edhe pse i mungon shqyrtimi gjyqësor dhe fokusohet në konkluzionet përfundimtare të palëve, nuk anashkalon parimin e barazisë së armëve dhe nuk zhvendos barrën e provueshmërisë. Në këtë kuptim, ajo gjykatë ka vlerësuar se barra e provueshmërisë i ka takuar Prokurorisë së Posaçme, e cila, me provat e mbledhura gjatë hetimeve paraprake, ka arritur ta tejkalojë, duke bindur në mënyrë të padyshimtë gjykatat se fakti penal është real dhe kërkuesi është fajtor. Lidhur me pretendimet se dyshimet duhet të çmoheshin në favor të të pandehurve, ajo gjykatë ka konkluduar se në atë gjykim nuk ka të tilla dyshime, pasi rezultati i provave të përfutuara e bën të padyshimtë fajësinë e dy të pandehurve.

15. Ajo gjykatë ka gjetur të pabazë edhe pretendimin se vendimi i apeluar është alogjik dhe se në të nuk është marrë në vlerësim argumenti bazë i mbrojtjes për shpëputje të marrëdhënieve midis të pandehurve. Nga provat e administruara në gjykim (ekspertimet kompjuterike të telefonave në përdorim të të dy të pandehurve dhe komunikimeve të përfutuara), është konfirmuar,

sipas saj, lidhja shoqërore mes të dyve, njohja e H.T. me zyrtarin e Ministrisë së Drejtësisë dhe implikimi i të dy të pandehurve së bashku në veprën penale të atribuar. Njohja dhe lidhja shoqërore mes të pandehurve nuk konfirmohet me datën e saktë të nisjes së saj, por nga të dhënat e përfutuara nga tabulatet telefonike dhe ekspertimi kompjuterik i telefonit të kërkuarit provojnë, sipas asaj gjykate, se mes dy të pandehurve ka pasur komunikime të vazhdueshme në telefon dhe në aplikacionin *Whatsapp*, që prej datës 03.11.2020, pra të paktën rreth një vit më parë se koha e pretenduar nga mbrojtja, ndërsa komunikimet e përfutuara nga ekspertimi i telefonave në mënyrë të padyshimtë provojnë se marrëveshja mes tyre ishte reale dhe më e hershme se koha së cilës mbrojtja i referohet. Pretendimin për vërtetësinë dhe përdorshmërinë e provës (regjistrimin e bisedës së publikuar në emision televiziv) ajo gjykatë e ka gjetur të pabazuar. Fillimisht ajo gjykatë ka evidentuar se ky pretendim është ngritur për herë të parë në ankim. Më tej ka arsyetuar se kërkesa për dërgimin në gjyq të çështjes ka kaluar në filtrin e kontrollit të gjykatës së seancës paraprake, e cila nuk ka konstatuar prova të pavlefshme ose të papërdorshme. Edhe gjykata e themelit ka çmuar se provat janë “pa cene” të vlerës ose përdorshmërisë dhe të mjaftueshme për të zgjidhur çështjen. Ajo gjykatë nuk ka gjetur asnjë shkelje të normave të procedurës penale në marrjen dhe përdorimin e provave të gjykimit. Po kështu, ajo gjykatë ka evidentuar se të pandehurit me vullnet të plotë i kanë pranuar provat në gjendjen e tyre, duke mos ia nënshtruar debatit gjyqësor, shpejtim procedure mbi të cilën ata kanë marrë përfitimet në masën e dënimit të caktuar. Në vijim, provën e regjistrimit të bisedës nga pajisjet “regjistruese” të emisionit televiziv, ajo gjykatë e ka konsideruar provë atipike, që edhe pse nuk është parashikuar shprehimisht nga KPP-ja, nuk ndalohet, e, për rrjedhë të logjikës së arsyetimit është gjetur me vlerë dhe e përdorshme në gjykim, dhe çmuarja e saj është bërë sipas nenit 152 të KPP-së, për aq sa në tërësi me provat e tjera të këtij gjykimi gjen konfirmimin e të dhënave të saj.

16. Lidhur me pretendimin se akuza ngrihet vetëm mbi bazën e deklarimeve të kallëzueses, ajo gjykatë ka arsyetuar se dëshmia e saj nuk është e vetmja provë që vërteton fajësinë e kërkuarit, por janë një sërë provash, të gjitha të vlerësuara për aq sa nuk kundërshtohen mes tyre dhe për konkluzionin e saktë që ato përcjellin. I pabazuar është vlerësuar edhe pretendimi se deklarimi i fajësisë është i paragjykuar dhe i njëanshëm, me argumentin se nuk është provuar që kërkuari të ketë vepruar duke dhënë përfitime për të ndikuar në mënyrë të paligjshme mbi personat që ushtrojnë funksione publike në kryerjen e detyrës dhe në marrjen e vendimeve. Për këtë, ajo gjykatë ka arsyetuar se vepra penale konfigurohet kur subjekti konsumon cilëndo sjellje të kundërligjshme të përshkruar, pra nuk kërkon që ndikimi paligjshëm i marrë përsipër të jetë kryer, ose të ketë dhënë rezultatin e kërkuar nga personi i tretë, por mjafton vetëm sjellja e paligjshme e

kërkimit, marrjes ose pranimi të përfitimit të rregullt, duke shfrytëzuar, në rastin konkret, pozitën e të bashkëpandehurit. Për pretendimin se të dhënat e aktit të ekspertimit teknik kompjuterik janë të pamjaftueshme, ajo gjykatë ka vënë në dukje se ka dy akte ekspertimi (i telefonit të kërkuesit dhe i atij të bashkëpandehurit), të cilat konfirmohen nga të dhënat e kompanisë telefonike përkatëse. Po kështu, këto akte ekspertimi janë çmuar se janë në harmoni me provat e tjera të llojeve “dëshmi”, “regjistrime”, “përgjime” dhe “prova dokumentare”, të cilat, të vlerësuara si në kronologjinë e ngjarjeve, ashtu edhe në përmbajtjen e tyre, i kanë dhënë të drejtën legjitime GJKKO-së së Shkallës së Parë që të jepte vendimin e fajësisë.

17. Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit të kërkuesit dhe ka arritur në përfundimin se ato ishin të ndryshme nga shkaqet e parashikuara në ligj, pasi në thelb përqendroheshin te bazueshmëria dhe provueshmëria e fajësisë së kërkuesit për kryerjen e veprës penale për të cilën është dënuar. Pavarësisht se ajo gjykate nuk i hyn vlerësimit të provave, ka shqyrtuar brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në rekurs nëse gjykatat më të ulëta kanë zbatuar drejt ligjin dhe nëse vendimmarrja e tyre është në standardet e një vendimmarrjeje të arsyetuar dhe ka arritur në përfundimin se pretendimet e ngritura në rekurs kanë marrë përgjigje të plota përmes vendimmarrjes së gjykatave të faktit. Ajo gjykatë ka konstatuar se pretendimet e rekursit marrin përgjigje nga vendimmarrja e gjykatës së apelit, e cila është argumentuar mjaftueshëm në këtë drejtim. Në lidhje me pretendimin për sa i përket vlerësimit të provës (regjistrimit të fshehtë të bisedës midis kërkuesit dhe kallëzueses), Gjykata e Lartë ka evidentuar se gjykatat e faktit e kanë vlerësuar si provë atipike, se nuk ka të dhëna nëse regjistrimi ishte i manipuluar. Gjithashtu, nuk ka të dhëna se kjo provë ka cenuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, për pasojë është konform nenit 8/a të KPP-së. Lidhur me këtë argument, ajo gjykatë ka bërë të saj arsyetimin e gjykatës së apelit.

18. Në referim të standardeve të mësipërme dhe bazuar në arsyetimin e vendimeve gjyqësore të dhëna ndaj kërkuesit, Kolegji vlerëson se gjykatat e faktit nuk rezulton që të kenë arritur në një konkluzion *apriori* për fajësinë e kërkuesit. Ato gjykata e kanë mbështetur vendimin për fajësinë e tij mbi analizën tërësore të provave të administruara në gjykim (shkencore dhe me dëshmitarë), të pasqyruara edhe në vendim, të cilat i kanë shqyrtuar e vlerësuar në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën, duke parashtruar në vendim edhe shkaqet mbi të cilat ato kanë arritur në përfundimin e shprehur në dispozitiv. Në veçanti, GJKKO-ja e Apelit ka marrë në shqyrtim dhe ka analizuar deklaratimet dhe pretendimet e kërkuesit, duke u dhënë përgjigje të argumentuara atyre. Arsyetimi i atyre gjykatave është marrë në shqyrtim edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili, në ushtrim të kompetencave të tij, i ka gjetur të drejta dhe të bazuara, duke i konsideruar të pabazuara

shkaqet e parashtuara në rekurs, si dhe ka parashtuar në vendim argumentet mbi të cilat ka bazuar qëndrimin e tij.

19. Kolegji vëren gjithashtu se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesën e kërkuarit për gjykimin e tij sipas rritit të gjyimit të shkurtuar, në gjendjen që ishin aktet, në kushtet që ai nuk ka pasur kundërshtime për mënyrën e marrjes së provave, për pavlefshmërinë ose papërdoshmërinë e tyre në gjykim, duke përfutur edhe uljen e dënimit që shoqëron këtë rit gjykimi. Ky pretendim është ngritur për herë të parë në ankim dhe më pas në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, sikundër në ankimin kushtetues individual.

20. Për sa u takon pretendimeve të kërkuarit për mënyrën e vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme, ashtu edhe ato për vlerësimin e ligjit penal material të zbatueshëm, nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues për sa kohë që, bazuar në arsyetimin e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, nuk rezulton që ato të jenë arbitrare ose haptazi të paarsyeshme, pra që të vënë në dyshim vetë thelbin e së drejtës për një gjykim të drejtë.

21. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

22. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.